



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 65 Prot.

Tiranë, më 15.01 2019

VENDIM Nr. 3, datë 15.01.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1, datë 15.01.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i rrugës "Kardhiq-Delvinë" Loti 4*-subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar, realizuar nga individët e licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka dhe Z. Skënder Muçaj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i rrugës "Kardhiq-Delvinë" Loti 4*-subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar, realizuar nga individët e licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka dhe Z. Skënder Muçaj.
2. Subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Ndërtimi i rrugës "Kardhiq-Delvinë" Loti 4, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO